



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulv: "Zhan D'Ark". Nr. 2
Tirana – ALBANIA

Tel: + 355 4 380 300

+ 355 4 380 333

Faks: + 355 4 379 826

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

Web-site: www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 132 Prot.

Tiranë, më 03/06/2008

Lënda: *Dergohet Raporti i veçantë "Për gjendjen e shendetit mendor ne Republiken e Shqiperise"*

Drejtuar: **Kryetares se Kuvendit te Shqiperise**

Zj. Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

Tiranë

E nderuara Znj. Kryetare e Kuvendit!

Raporti i veçante Nr.2 qe po ju paraqesim eshte nje sinteze e perpjekjeve te vazhdueshme te Institucionit te Avokatit te Popullit gjate ketyre 8 viteve per te sensibilizuar organet shteterore dhe opinionin publik rreth gjendjes se shendetit mendor ne vendin tone, si dhe rekomandimet per përmiresimin që duhet bërë në këtë fushë të shëndetësisë.

Ky raportim bëhet në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore, si dhe per te vene ne zbatim detyrat e lena nga Kuvendi i Shqiperise per te prezantuar gjate vitit tematika te rendesishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve te Posaçme.

Paraqitja e ketij Raporti bazohet ne nenin 63, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme", si dhe ne nenin 27 te Ligjit Nr.8454 date 04.02.1999 "Per Avokatin e Popullit", te ndryshuar, ku thuhet se:

"Perveç raportimit ne kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund te raportoje para Kuvendit me nismen e tij ose me kerkesen me shkrim te Kryetarit te Kuvendit ose te nje grupi deputetesh. Kryetari i Kuvendit vlereson nese ky raportim do te behet:

- a. ne seance plenare;
- b. me shperndarje te raportit;
- c. ne komisionet e perhershme te Kuvendit;

Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport”.

Referuar sa me lart, do te sugjeronim që ky Raport i veçantë të shqyrtohet në një seancë të vetme në Komisionet e përhershme të Kuvendit, me pjesëmarrjen e deputetëve të të dy Komisioneve të përhershme: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit te Punes, Çështjeve Sociale dhe Shendetësise.

Besojmë se Kuvendi i Shqiperise do ta konsiderojë dhe perdore kete Raport te veçante si mjet, i cili do te bëjë të mundur njohjen dhe marrjen e masave te duhura per te permiresuar sa me pare gjendjen e sherbimit te shendetit mendor ne vend.

Luteni që pasi të vendosni se si dhe para kujt do të shqyrtohet ky Raport, të njoftohemi për t’u paraqitur.

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Ermir DOBJANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT I VEÇANTE

Nr.2

Për gjendjen e shëndetit mendor në Shqipëri

2008

1. Objekti dhe qellimi i Raportit të veçantë "Për Shëndetin Mendor në Republikën e Shqipërisë"

Nuk është e rastit që qysh në fillimet e veprimtarisë së tij në vitin 2001 dhe deri vitet e fundit, Avokati i Popullit është fokusuar në gjendjen e të semurëve mendore dhe në trajtimin e tyre në qendrat shëndetësore. Kjo vëmendje është kushtuar për arsye se sëmundjet mendore i bëjnë këta individë qeniet më të vulnerabile në shoqëri dhe me të ekspozuar ndaj dhunës, trajtimit çnjerezor dhe degradues.

Në një shoqëri demokratike të gjithë aspirojmë nivelin më të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut, por ky nivel nuk matet tek trajtimi i "me të forteve", por tek ata që kërkojnë përkrahje dhe ndihmë, tek me të dobët.

Në këtë kuptim, mendojmë se detyra që kemi kryer gjatë këtyre viteve në ndihmë të këtyre personave është një nga shërbimet më të çmuara që i kemi bërë vlerave të vërteta të demokracisë.

Avokati i Popullit beson se humanizmi i institucioneve shtetërore dhe përgjegjshmëria e tyre ndaj respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve me probleme shëndetësore janë gurët e themelit për një shërbim publik të suksesshëm shëndetësor.

Realisht problemet që ngrihen në këtë Raport janë sendertuar konformë sjelljes që administrata publike shqiptare ka dashur t'i japë ndër vite çështjeve të ngutshme të shëndetit mendor. E vërteta qëndron se në shumicën e tyre idetë për zgjidhjen e shumë mangësive në këtë shërbim kanë mbetur thjesht dhe vetëm në fazën e hartimit të programeve dhe strategjive përkatëse.

Kjo del nga fakti se për aspekte themelore të ndihmës dhe perkujdesjes individuale ndaj të semurëve është menduar me shumë që t'i lihet zgjidhjeve nga projekte të partnereve të huaj. Dallimi qëndron në faktin se administrata shqiptare ka hedhur në lehtë detyrat e saj për të përmirësuar sistemin, ndërsa shoqatat dhe donatorët e huaj kanë punuar drejtperdrejtë për trajtimin e nevojave të ngutshme të të semurëve mendore.

Ky dallim dhe mangësitë në përgjithësi që ofron shërbimi shëndetësor për këta kategori personash në vendin tonë janë elementet bindës që provojnë se ende në Shqipëri mungojnë kushtet për rehabilitimin dhe shoqërizimin e personave me probleme mendore. Madje ka të dhëna të plota për të konkluduar se mjedisi dhe shërbimi shpesh jashtë standarteve i Spitaleve Psikiatrike rëndon edhe më tej shëndetin mendor, duke e bërë të

pamundur permbushjen për një kohë të shpejtë e misionit për të cilën ato janë ngritur.

Evidentojmë se Republika e Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë të Shëndetësisë ka nënshkruar Kartën e Shëndetit Mendor për Rajonin Europian të OBSH-së në vitin 2005 në Finlandë. Ky veprim dhe prezenca e vazhdueshme e organeve përkatëse shqiptare në organizmat ndërkombëtare që elaborojnë projekte të shëndetit mendor është një përgjegjësi që duhet mbajtur në konsideratë me seriozitetin më të lartë.

Ajo çka sot shihet me mjaft shqetësim në Europë, e cila duhet të na zgjojë edhe në nga letargjia është fakti se tranzicioni i zgjatur i shumë vendeve, veçanërisht të Ballkanit Perëndimor ka patur ndikim negativ, duke rritur numrin e njerezve të prekur me probleme mendore. Përqindja e njerezve me skizofreni që nuk trajtohen me mjekim është rritur nga 36% në 45%. Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH (WHO 2003-2006) 47% e personave që vuajnë nga depresioni nuk marrin kurim për shkak të mungesës së një sistemi efikas shëndetësor, mos diagnostikimit apo të problemeve që kanë me mentalitetin e tyre. Ky ka qenë një nga shkaqet kryesore të rritjes së numrit të vetevrasjeve apo ngjarjeve të tjera që kanë patur për protagonistë të semurës mendore.

E njëjta gjendje në disa raste ka çuar që në vendin tonë të kemi jo pak raste flagrante të shfaqjes agresive të sëmurëve mendorë si psh. *rasti i vrasjes së një të mituri në Diber; sulmet sistematike të një të semuri mendor në disa zyra publike në Tiranë; tentativa e vrasjes së një kirurgu në Tiranë; vrasesi i mitur në Bërë; sulmi ndaj hyrjes së selisë së Presidencës dhe së fundi vrasja në qendër të Qytetit të Himarës, të gjitha të realizuara nga të semurë mendore të diagnostikuara ose jo si të tilla.*

Adresimi i këtyre problemeve në Kuvendin e Shqipërisë bëhet sepse situata e konstatuar në këto shtetshëndetësor dhe niveli i reagimit të administratës publike shqiptare ndaj tij nuk janë në standartet e kerkuara.

Avokati i Popullit është përpjekur që këto dhe të tjera probleme që hasen rëndom në këto fushë të pasqyrohen në këtë Raport me vertetësinë më të madhe, pasi çështja e shëndetit mendor është një nga temat më të ndjeshme edhe nga partneret ndërkombëtarë sa herë që diskutohen kapacitetet institucionale të shtetit tonë për respektimin e të drejtave të njeriut.

Me cilesinë e organit më të lartë në vend, Kuvendit të Shqipërisë i sugjerojmë të japë mendimin, vërejtjet, propozimet dhe të bëjë miratimet e duhura ligjore për problemet që do të parashtrihen në vijim, me qëllimin që të përmirësohet sa më shpejt gjendja e të semurëve mendore në Republikën e Shqipërisë.

2. Kuadri ligjor dhe problematikat e tij ne trajtimin e shendetit mendor ne Shqiperi

Avokati i Popullit ne hartimin e ketij Raporti, krahas problemeve konkrete qe jane hasur ne disa fusha ku trajtohen te semuret mendore, ka identifikuar se çeshtje te veçanta qe ndikojne negativisht ne te drejtat dhe trajtimin e pacienteve vijne edhe si pasoje e mosnjohjes se legjislacionit, zbatimit te gabuar te tij dhe neglizhences per te respektuar te drejtat kushtetuese dhe ligjore te tyre nga ana e organeve shteterore kompetente.

Shkurtimisht ne vijim po ju prezantojme dokumentat ligjore me kryesore qe jo vetem parashikojne menyren e trajtimit dhe respektimit te te drejtave ndaj këtyre të semureve, por dhe qe evidentojne qarte problemet qe hasen qe nga viti 2000 e deri ne ditët e sotme.

I) Nje dokument i rendesishem qe ka zene vend te veçante ne legjislacionin tone te brendshem dhe qe shpesh here eshte bere objekt konsultash per te marre dhe per te arritur standartet bashkekohore eshte Dokumenti “Mbi Rregullat Europiane te Burgut”, miratuar nga Keshilli i Europes dhe deleguar per zbatim anetareve te tij me ane te rekomadimit Nr. 87/3 te Keshillit te Ministrave te vendeve anetare te Keshillit te Europes.

Ndermjet shume rregullave te veçanta qe zene vend ne kete Dokument, ne kemi veçuar piken 100.1 qe percakton se personat qe konstatohen me probleme mendore nuk duhet te mbahen ne burg, por duhet te dergohen sa me shpejt qe te jete e mundur nga burgjet ne vende te pershtatshme per këtë kategori personash.

Ne nje analize me te detajuar qe do te japim ne vazhdim, ky rregull ne vendin tone eshte zbatuar ne menyre te gabuar dhe ka bere qe mjaft paciente te mbahen dhe të mjekohen ne kushte burgu dhe izolimi te plote.

Kjo praktike eshte kritikuar jo vetem nga Avokati i Popullit, por edhe nga Keshilli i Europes nepermjet Komitetit te tij per Parandalimin e Tortures pas inspektimeve qe ka bere ne Shqiperi. Por deri tani nuk jane marre të gjitha masat e duhura për të përmirësuar situatën.

II) Kodi Penal i Republikes se Shqiperise ne nenin 45 te tij ka përcaktuar se masat mjeksore mund të jepen nga Gjykata ndaj personave të papërgjegjegjëshëm që kanë kryer vepër penale, te cilat jane mjekimi i detyruar ambulator dhe mjekim i detyruar në një institucion mjeksor. Pra në një institucion mjekësor, por jo në burgje.

Kjo dispozite dhe shpjegimi qe do te jepet ne vijim per aplikimin e gabuar qe i behet asaj ne praktike jane prova me e qarte se si cenohen prej nje kohe te gjate te drejtat e këtyre personave në vendin tonë.

III) Ligji Nr.8331 date 21.4.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale” ne nenin 45 te tij percakton midis te tjerash se vendimet qe jep gjykata per mjekim te detyruar ekzekutohen ne institucionin mjeksor te specializuar, sipas percaktimit qe ben Ministria e Shendetesise mbi kerkesen e prokurorit.

Nje rregulli të tillë në shume raste nuk i është dhënë kuptimi i drejte dhe zbatohet gabim me dashje, duke i mbajtur te semuret mendore ne kushte burgu dhe shpesh edhe pa ndihmen e mjekut specialist. (*Rasti i Spitalit te Burgut ne Kruje, i cili nuk ka mjek psikiater*).

IV) Ligji Nr.8092 dt. 03. 02. 1996 ”Per Shendetin Mendor” eshte ligji baze me ane te te cilit jane percaktuar rregullat kryesore se si do te duhet te organizohet dhe te funksionojte sherbimi i shendetit mendor ne vend. Ky ligj midis te tjerash ka parashikuar nje sere te drejtash ne favor te pacienteve.

Nga inspektimet tona te shpeshta ne Spitalet Psikiatrike, per te cilat do te flasim me poshte, eshte vene re se ky ligj permban nje sere dispozitash te pazbatueshme dhe vete permbajtja e tij eshte vene ne diskutim dhe kontestim disa here.

Konkretisht ne vijim po paraqesim shkurtimisht disa probleme qe ka ky ligj:

a) Ligji eshte bere objekt diskutimi per t`u shfuqizuar dhe ndryshuar disa here. Madje ne Planin e Veprimit te Vitit 2005 per shendetin mendor te miratuar nga Ministria e Shendetesise eshte parashikuar qe ky ligj te ndryshohet. Nje sugjerim te tille Ministria e Shendetesise e ka marre edhe nga OBSH-ja. Por megjithë janë bërë disa mbledhje dhe tavolina te rrumbullakta per kete problem, te organizuara gjate vitit 2006, nuk eshte marre asnje iniciative konkrete. Madje nga studimi i planit te matricave per aktet qe do te propozohen per miratim gjate vitit 2008 nga ana e Ministrise se Shendetesise konstatohet se ky ligj nuk permendet per trajtim.

b) Per mendimin tone, por dhe te disa eksperteve te tjere, madje edhe nderkombetare, ky ligj ne permbajtjen e tij eshte mjaft i vjeter dhe nuk i pershtatet zhvillimeve te reja, qofte edhe ne planin e perafimit te legjislacionit. Brenda tij ka referime te vjeteruara per organet pergjegjese per zbatimin e ligjit dhe nuk ka specifikime te reja mbi organet e kontrollit te jashtem qe do te monitorojne kete sherbim si psh Mekanizimi i Parandalimit te Tortures, qe ka filluar të funksionojë prane Avokatit te Popullit.

c) Ky ligj ka mbetur pothuajse i ngrire dhe nuk eshte plotësuar me tej me akte nenligjore qe do ta benin ate nje ligj te zbatueshem dhe te plotë për organet shtetore. Megjithese ligji urdheron nxjerrjen e rregulloreve te perbashketa per disa probleme kyçe te zbatimit te tij, keto akte edhe sot nuk

jane miratuar. Per keto mungesa ne veçanti do te flasim ne vijim, por ajo qe duhet marre ne konsiderate eshte fakti se Ministria e Shendetesise i ka patur te gjitha mundesite t`i nxjerre keto akte nenligjore ne bashkepunim edhe me Ministrine e Drejtesise dhe Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, por deri me sot nje gje e tille nuk ka ndodhur.

Per me teper, edhe atehere kur vete ligji ka urdheruar nxjerrjen e nje akti specifik, siç eshte Rregullorja mbi kufizimet fizike te pacientit, Ministria e Shendetesise ne menyre te padrejte ka inkorporuar disa dispozita te pergjithshme per kete çeshtje brenda Rregullores se sherbimit te shendetit mendor, te miratuar ne Prill 2007. Per shembull nje dispozite qe e ben te pazbatueshem kete ligj per kohen e sotme eshte fakti se ai ngarkon autoritetet mjeksore te spitaleve psikiatrike qe ne raste te ngutshme per te neutralizuar te semure te veçante, te shfrytezojne edhe forcat e zjarrfikeseve ???

V) Nje tjetër akt ku parashikohen rregulla te veçanta per te burgosurit qe vuajne nga shqetesimet mendore eshte edhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave me Nr. 96 dt.09.03.2000.

Në nenet 93 dhe 94 të kesaj Rregullore është përcaktuar në mënyrë eksplicite ndarja e personave me sëmundje mendore qe vuajne denimin nga te denuarit e tjere, duke i transferuar ne kushte spitalore. Ne realitet, ashtu siç do te njiheni edhe ne vijim, kushtet spitalore te sotme per keta paciente te denuar jane serish burgje, por ku ofrohet sherbim mjeksor.

Shpesh Avokati i Popullit eshte munduar t`i binde autoritetet e Ministrise se Drejtesise dhe Shendetesise per faktin se spitalet e sotme te burgjeve nuk plotesojne asnje kriter per te qene spitale te mirefillta, por jane thjesht burgje qe ofrojne mjekim. Trajtimi qe ju behet pacienteve te denuar qe qendrojne ne keto ambjente eshte i papranueshem per kohen dhe standartet e kerkuara.

VI) Ne vitin 2003, me ane te Urdherit Nr. 116 dt. 25.03.2003 te Ministrit te Shendetesise u miratua dokumenti politik "Per zhvillimin e shendetit mendor" ne vendin tone. Nder te tjera, nga ky dokument del si detyre deinstitutionalizimi i pacienteve qe qendrojne pa kurrfare simptomatike akute ne spitale, per t`i nxjerre ata nga keto ambjente dhe per t`i sistemuar ne qendra komunitare. Gjithashtu, ne kete kuader eshte marre angazhimi edhe per decentralizimin e sherbimit te shendetit mendor, per ta ofruar ate me afer qendrave komunitare.

Nje çeshtje te rendesishme qe preku ky dokument ishte dhe perforcimi i kapaciteteve monitoruese te respektimit te te drejtave te pacienteve, kur konstatohen shkelje brenda sistemit te spitaleve apo ne qendrat komunitare, ku duhet te mbahen keta te semure.

Per teresine e angazhimeve te paraqitura nga ky dokument del se nuk ka patur ndonje efekt permiresues te situates. Eshte e vertete qe proçesi i deinstitutionalizimit ka filluar, por ai ka qene i reduktuar dhe me teper protagoniste ne kete proçes kane qene vetem donatoret dhe shoqatat vendase dhe te huaja.

Ndersa lidhur me decentralizimin e sherbimit, rezulton se ai eshte zhvilluar i cunguar dhe nuk po jep eficënsë ne praktike per te diagnostikuar, mjekuar dhe mbajtur nën kontroll pacientet në komunitet. Kjo perben edhe “Thembren e Akilit“ dhe eshte shkaku per mjaft ngarje me pasoja te renda. Askush në Shqipëri nuk eshte i informuar se si do te duhet të trajtohen personat e semure mendore te çekulibruar qe verehen rrugeve dhe qe shpesh here rrezikojne jeten e qytetareve, apo prishin rendin, qetesine dhe etiken publike me ane te gjesteve dhe veprimeve aspak te hijshme te tyre. Veç Policisë së Shtetit që ndërhyt në keto raste, konstatohet se situata është jashtë kontrollit.

Lidhur me monitorimin e situates se te drejtave te njeriut, konstatojme se tashme vendi yne ka ngritur nje Mekanizem te veçante, siç eshte ai i parandalimit te tortures prane Avokatit te Popullit, (*detyrim ky qe buron nga Protokolli Opsional i Konventes per Parandalimin e Tortures dhe Akteve te tjera Çnjerezore dhe Degraduese, i ratifikuar me ane te Ligjit Nr 9094 dt.03.07.2003*). Avokati i Popullit krahas monitorimit te ambjenteve te burgjeve, paraburgimit etj, ka mandat te plote nga aktet nderkombetare dhe legjislacioni yne ne fuqi per te ndjekur nga afer edhe respektimin e te drejtave dhe trajtimit te semureve mendore.

Ne kete kuader, do te ishte shume e rendesishme qe në rast se do te mundesheshin ndryshimet radikale ne Ligjin “Per Shendetin Mendor“, nje rol te veçante ne amendimet e reja duhet te ketë edhe ky Mekanizem per vete garancite qe ai mban ne vetvete per procesin e monitorimit qe merr persiper edhe per keta persona te semure. Veç kësaj ligjvënësi sipas Protokollit Opsional detyrimisht duhet t`i marrë në konsideratë mendimet e Mekanizmit (Avokatit të Popullit) në këtë fushë.

VII) Me ane te Urdherit Nr.226 dt.13.05.2005 Ministri i Shendetesise ka miratuar Planin e Veprimit per Zhvillimin e Sherbimit te Shendetit Mendor 2005-2009.

Si kryefjale e ketij dokumenti u shtrua domosdoshmeria per te rishikuar Ligjin “Per Shendetin Mendor“ dhe aktet e tjera qe duhet te dilnin ne baze e per zbatim te tij. Ashtu siç konstatohet lehtesisht, megjithese ky plan veprimi eshte ne vitin e parafundit te zbatimit te tij, per kete çeshtje kaq madhore, rezulton se nuk eshte marre pothuajse asnje mase konkrete.

Plani i veprimit merr persiper te ngreje me ane te akteve nenligjore te reja (Vendimeve te Qeverisë) struktura efikase ne ndihme te permiresimit

te shendetit mendor. Por ne kontradike me kete detyrim, disa pjese te sherbimit jane krijuar me nje Rregullore te pergjithshme te sherbimeve mendore, si një akt i Ministrit të Shëndetësisë, e cila kurrsesi nuk mund te realizojë qellimet që ka vënë Plani i Veprimit.

Arsyeja se pse disa struktura shendetesore të shendetit mendor duhet te ngrihen me vendime te Qeverise eshte nevoja per ti dhene rendesine e duhur atyre ne fushen mjeksore si dhe per mbeshtetjen e plote financiare, ne ndihme te komunitetit ne nevoje.

Plani i veprimit jep nje vizion te qarte per deinstitutionalizimin e pacienteve, por nuk specifikon aspak masat qe duhet te merren per te koordinuar dhe detajuar kete proces qe ai te funksionojë me hapa me te shpejte ne praktike.

Aktualisht, edhe sipas vete ketij dokumenti, ka nje numer te paperfillshem pacientesh qe po zhvendosen ne qendra komunitare dhe ka nje buxhet fare te paperfillshem per te perballuar nje fluks me te madh te tyre drejt qendrave komunitare.

Nje detyre e rendesishme qe del nga permbajtja e ketij dokumenti eshte edhe hartimi i politikave rehabilituese nga Ministria e Shendetesise dhe Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta. Por deri me sot nuk gjendet te jete miratuar ndonje dokument i tille.

Nderkohe qe ky Plan Veprimi ka parashikuar nisma per miratimin e rregulloreve te veçanta mbi kufizimin fizik, imobilizimin, izolimin, mjekimin qe kerkon lejen paraprake te pacientit apo vete familjareve dhe bashkepunimin me policine, ne realitet eshte pare e udhes qe nga Ministria e Shendetesise te nxirret vetem nje Rregullore e pergjithshme e sherbimit mendor, e cila rregullon vetem kufizimin fizik, por ne menyre teper te cunguar.

VIII) Rregullorja e Sherbimeve te Shendetit Mendor, miratuar nga Ministri i Shendetesise ne Prill 2007 eshte nje akt teper i vonuar per venien ne zbatim te urdherimeve te Ligjit “Per Shendetin Mendor”. Rezulton se kjo Rregullore ne teresine e saj, eshte munduar te rregulloje çeshtje te veçanta te pa rregulluara ne ligj. Prandaj ne shume aspekte ka kapercyer elementet e nje akti nenligjor, duke dale keshtu mbi ligjin ne fuqi.

Ky konstatim buron nga fakti se nepermjet saj jane krijuar organe te reja, siç eshte Komiteti Drejtues Kombetar i Shendetit Mendor, Sektori i Shendetit Mendor ne Ministrine e Shendetesise, Qendrat Komunitare, emertesa keto qe nuk kane pasqyrim ne ligjin e mesiperm. Krahas kesaj, shume aspekte te veçanta, te cilat ligji i mesiperm i konsideron si detyrime per te nxjerre rregullore me vehte, jane inkluduar pa te drejte ne kete Rregullore te Pergjithshme, e cila i ka pasqyruar ato te reduktuara. I tille

është rasti i rregullores mbi përdorimin e kufizimeve fizike, shtrimeve të pavullnetshme etj, për të cilat u fol edhe më lart.

Ne përfundim mund të përmendim edhe një raport vleresimi të OBSH-se, të botuar në Nentor 2007 mbi gjendjen në shërbimin e shëndetit mendor në Shqipëri, i cili ka bërë një përshkrim të detajuar të gjendjes.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti bien në sy disa përfundime siç janë:

- a) Mungesa e kuadrave ligjorë për shëndetin mendor;
- b) Nevoja e përmirësimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut ndaj personave me probleme mendore;
- c) Mungesa e një buxheti të konsiderueshëm për të përballuar nevojat e kësaj kategorie pacientesh dhe këtij shërbimi në përgjithësi, sipas strategjive të caktuara;
- ç) Mungesa e njohjes dhe mos zbatimi i vazhdueshëm i legjislativës në fuqi që trajton shëndetin mendor nga ana e organeve kompetente shtetërore;
- d) Mungesa e aktiviteteve promovuese dhe parandaluese të shëndetit mendor.

Nga shqyrtimi i çështjeve të mësipërme, Avokati i Popullit ka konstatuar se perceptimi i monitorimit të kësaj fushe të shëndetësisë edhe nga subjektet ndërkombëtare është pothuajse i njëjti me atë që ka Avokati i Popullit dhe organizatat e tjera jo qeveritare shqiptare. Kjo e vërteton edhe një herë të metat e mëdha nga të cilat vuan ky shërbim dhe që mund të diktohen shumë lehtë nga çdo individ, shoqatë apo organ shtetëror që ka interes ta bëjë këtë.

3. Problematikat e Shëndetit Mendor në Sistemin e Burgjeve

Sistemi i burgjeve në vendin tonë shpesh është kritikuar si një infrastrukturë e papërshtatshme për të kryer shërbimet e domosdoshme kundër të dënuarve apo atyre që vuajnë një masë denimi provizor.

Problemi më i madh që haset në këtë fushe lidhur me shëndetin mendor është se brenda sistemit të burgjeve mbahen pa të drejtë dy kategori të personave me probleme mendore, të cilët duhet të transferohen sipas ligjit në spitale të specializuara për shëndetin mendor.

Konkretisht këto dy kategori janë personat që gjatë vuajtjes së denimit shfaqin probleme mendore dhe personat që kanë kryer vepra penale, por për të cilët gjykata urdheron mjekimin e tyre të detyrueshëm në kushte spitalore, sepse janë të papërgjegjshëm. Ne vijim po paraqesim gjendjen se si këto dy kategori personash vijojnë të trajtohen në mënyrë jo ligjore nga organet shtetërore.

Tek Avokati i Popullit që në vitin 2001 është paraqitur ankesa e disa familjareve të personave të papërgjegjshëm që kishin kryer vepra penale dhe që gjykata kishte vendosur masën mjeksore të mjekimit të detyruar në një institucion mjeksor. Ata u ankuan se të afërmit e tyre mbaheshin padrejtesisht në Spitalin e Burgjeve në Tiranë për periudha shumë të gjata kohe, në kundërshtim me ligjin.

Nga verifikimi që ju bëmë këtyre pretendimeve rezultoi se ata kishin të drejtë. Në të gjitha rastet që gjykatat tona në gjithë vëndin kishte vendosur ndaj të sëmurëve psiqikë, masën mjeksore të mjekimit të detyruar në një institucion mjeksor, këta persona ishin dërguar për ekzekutimin e kësaj mase në Spitalin e Burgjeve Tiranë.

Në vitin 2001 në këto kushte ishin 34 persona, ndërsa aktualisht ashtu siç do të flitet edhe me tej në këtë raport, në Spitalin e Burgjeve Tiranë janë rreth 70 persona me masë mjeksore të mjekimit të detyruar. Nga inspektimet tona të vazhdueshme është konkluduar se kjo qender nuk dispononte kushte për rehabilitimin mendor të këtyre të semurve, për rrjedhojë gjendja e tyre ka ardhur duke u rënduar dhe jo siç duhet të ishte në fakt, të shërbente për kurimin tyre.

Kjo qëndër ishte dhe vijon të mbetet një spital burg brenda administrimit të sistemit të burgjeve dhe veç të tjerave ka si funksion të mbajë dhe trajtojë edhe të dënuarit me burgim që kanë probleme shëndetësore.

Ndërsa sipas ligjit personat e sëmurë psiqikë që kanë kryer vepra penale duhet të mbahen jashtë sistemit të burgjeve, në një institucion mjeksor, në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Qendra Spitalore e Burgjeve në Tiranë është kthyer në një vend ku mbahen në mënyrë të paligjeshme të semuret psiqike për të cilët gjykata ka dhënë masën mjeksore të mjekimit të detyruar. Janë një varg dispozitash ligjore që urdhërojnë mbajtjen e trajtimin e personave të papërgjegjshëm (të sëmurë mendor), për të cilët gjykata ka vendosur pushimin e hetimeve për veprat penale të kryera prej tyre dhe mbyllet në një institucion mjeksor, dhe konkretisht:

Sipas nenit 45 të ligjit nr.8331 datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” masat mjeksore me mjekim të detyruar duhet të ekzekutohen në institucionin mjeksor të specializuar sipas përcaktimit që ben Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit.

Po kështu, në nenin 46, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se kur gjykata vendos masën mjeksore të mjekimit të detyruar duhet që personi të mbyllet në një institucion psikiatrik.

Veprimet e mesiperme kanë qenë në kundërshtim me rekomandimin nr.87.3 të Konventës Europiane për të drejtave të njeriut “Mbi Rregullat

Europiane te Burgut“. Siç thame edhe me siper ne piken 100.1 percaktohet se personat qe konstatohen te çmendur nuk do te mbahen ne burg, por duhet te zhvendosen sa me shpejt qe te jete e mundur ne vende te pershtateshme.

Edhe neni 28, pika 5 e Kushtetutes se Republikes se Shqiperise ju garanton ketyre personave nje trajtim njerëzor.

Kurse në nenet 93 dhe 94 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 96 dt.09.03.2000 është përcaktuar në mënyrë eksplicite ndarja e qartë e personave me sëmundje mendore që bëhen të tillë gjatë vuajtjes së dënimit dhe personave të papërgjegjshëm të shpallur të tillë nga gjykata, e cila i ka përjashtuar nga burgimi, por ka vendosur mbylljen e tyre në institucione të posaçme psikiatrike.

Në nenin 94 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve thuhet: *“Personat që kanë kryer vepra penale dhe konstatohet se janë të papërgjegjshëm nga gjykata , nuk duhet të mbahen në burg , por sa më shpejt të jetë e mundur duhet të vendosen në Institucionet psikiatrike sipas parashikimeve të Ligjit nr. 8092 datë 21. 03.1996 “Për Shëndetin Mendor”.*

Referuar dispozitave te mesiperme, më 18 Qershor të Vitit 2001 Avokati i Popullit i dërgoi Prokurorisë së Rrethit Tiranë Rekomandimin “Për nisjen e procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, kundër punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë , që kishin lejuar mbajtjen e personave me masë mjeksore, brenda sistemit të burgjeve”

Mbi bazën e rekomandimit tonë, Prokuroria e Rrethit Tiranë filloi procedimin penal nr. 961 që bën fjalë për shkeljen e të drejtave të të sëmurëve mendore që mbahen padrejtësisht brenda sistemit të burgjeve. Mbas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, me vendimin e datës 05.03.2003, Prokuroria vendosi pushimin e çështjes penale Nr. 961 datë 05.03.2003 me arsyetimin se *“nga hetimet e kryera ka rezultuar se autoritetet e Spitalit të Burgjeve pengohen që të disponojnë daljen e të sëmurëve nga spitali, përderisa nuk ka një urdhër për transferimin e tyre në një institucion të përshtatshëm rehabilitimi dhe përderisa gjëndja e tyre shëndetësore vazhdon të jetë e rënduar“.*

Sipas vendimit te prokurorit “hetimet provuan se të shtruarit vuajnë nga patollogji të ndryshme neuropsikiatrike, të cilat i bëjnë ata të rrezikshëm për shoqërinë. Nga hetimet provohet se Spitali Psikiatrik i Elbasanit ka funksionuar deri në datën 14.03.1997 dhe që nga ajo datë dhe deri tani (dt.05.03.2003) nuk funksionon më si institut i trajtimit të pesonave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar.Në këto rrethana në mungesë të institucioneve të tjera të përshtatëshme , është

gjetur si zgjidhje e përkohëshme trajtimi në Spitalin e Burgjeve Tiranë, i cili është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që plotëson kushtet e sigurisë për të sëmurët mendorë, për të cilët gjykata ka vendosur masën e mjekimit të detyruar. Një zgjidhje e tillë, ndonëse e përkohëshme, nuk plotësonte kriteret e pranuar nga ligji dhe nga aktet ndërkombëtare për trajtimin e të sëmurëve mendorë. Por sikundër u argumentua më sipër, kjo ka qënë një zgjidhje e detyruar për shkak të mungesës së institucioneve të përshtatëshme për trajtimin e të sëmurëve mendorë të cilët nëse do të trajtoheshin në institucione të tjera, në mungesë të kushteve të përshtatëshme të sigurisë, mund të rrezikonin personelin e shërbimit dhe mund të largoheshin duke paraqitur rrezik imediat për të gjithë shoqërinë“.

Në këto rrethana, sipas prokurorisë, “hetimet nuk evidentonin veprime apo mosveprime të kryera me dashje, në kundërshtim me ligjin, që kanë sjellë si pasojë trajtimin e të sëmurëve mendorë në spitalin e burgjeve, përkundër trajtimit të tyre në Institucione të posaçme psikiatrike. Pra nuk formohen elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal dhe as ka persona përgjegjës, përderisa një zgjidhje e tillë ka qënë e detyruar nga mungesa e institucioneve të përshtatëshme në vënd“.

Siç duket qartë nga ky argumentim, ky vendim ishte dhe mbetet kontradiktor për shkak se pranon se vendosja e këtyre të dënuarve është e përkohëshme dhe në kundërshtim me ligjin dhe aktet ndërkombëtare. Kjo do të thotë se nuk duhet të perjashtoheshin nga përgjegjësia ata zyrtarë që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, duke i mbajtur këta persona brenda sistemit të burgjeve.

Sipas prokurorisë personi përgjegjës në atë kohë ishte zv. Ministri i Shëndetësisë, i cili kishte caktuar Spitalin e Burgjeve si vëndi ku do të qëndrojnë këta persona. Në kushtet dhe situatën e njëjtte me të cilën po vijohet të trajtohet ky problem edhe sot, mendojme se përgjegjësia e drejtuesve të tjerë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë është e evidente dhe nuk duhet lejuar që me neglizhencën e tyre të metejshme të vazhdojnë të shkelin në mënyrë flagrante aktet ndërkombëtare dhe legjislativonin në fundi.

Përpjekjet e zyrës së Avokatit të Popullit për zgjidhjen e këtij problemi janë bërë edhe nëpërmjet rekomandimit për plotësimin e kërkesave të ligjit Nr.8092 dt. 03. 02. 1996 ”Për shëndetin mendor”, për të nxjerre rregulloren “*Per masat e sigurimit te personave për të cilët gjykata ka vendosur masën mjeksore të mjekimit te detyruar*”.

Kjo kërkesë buron nga neni 42 i Ligjit Nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”, që thotë se: “*Masat e sigurimit për personat e përmendur në nenin 41(personat për të cilët është marrë një masë mjeksore) merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen e tyre, sipas*

rregullores së miratuar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë”.

Mungesa e vëndit (spitalit të veçantë) dhe e rregullores veç te tjerash ka çuar, që edhe sot rreth 70 te dënuar me masë mjeksore vazhdojnë të qëndrojnë ne kundershtim flagrant me ligjin brenda sistemit te burgjeve (në spitalin e Burgjeve), në të njëjtën kohë kur neni 46 i K.Penal ka përcaktuar se: *“Masat mjeksore mund të jepen nga Gjykata ndaj personave të papërgjegjëgjëshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale”.*

Masat Mjeksore janë:

a) Mjekimi i detyruar ambulator

b) Mjekimi i detyruar në një institucion mjeksor etj , pra në një institucion mjekësor e jo në një institucion brenda sistemit të burgjeve.

Paketa ligjore për burgjet ka një sërë dispozitash ku është përcaktuar se edhe një pacient me të meta mendore gëzon të drejta të njëjta si të gjithë të tjerët. Në vështrim të pikës 5 të nenit 28 të Kushtetutës sonë është përcaktuar detyrimi i trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të çdo të burgosuri. Administrata publike është e detyruar të respektojë këtë standart edhe për të burgosurit me probleme mendore. Respektimi i të drejtave si ato për të mos u keqtrajtuar, torturuar, fyer apo dëmtuar në çfaredo lloj mënyre duhet të jetë fillesa e veprimtarisë në institucionet penitenciare, ku mundësia e abuzimit me të drejtat dhe liritë e tyre është akoma më e madhe se tek të burgosurit e tjerë.

Me kete rast ju duhet vene ne vemendje edhe çeshtja e trajtuar nga Gjykata e te Drejtave te Njeriut e Keshillit te Europes me qender ne Strasburg, (Dybeku kunder Shtetit Shqiptar 2007) ku mbajtja e ketij te burgosuri me te meta mendore ne ambjentet e burgut u quajt si shkelje e Konventes se Mbrojtjes se te Drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut, duke i caktuar shtetit shqiptar edhe nje gjobe dhe shpenzimet e gjykimit ne ngarkim.

Në vitin 2004, Avokati i Popullit i ka derguar Ministrit të Shëndetësisë nje rekomandim për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.2004 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”, nëpërmjet të cilit kemi kërkuar marrjen e masave që brenda një kohe të shkurtër të përcaktohet vëndi ku do të dërgohen të sëmuret mendor me masë mjeksore.

Këto rekomandime nuk gjetën mirëkuptimin e drejtuesve të Ministrisë së Shëndetësisë, pasi kabineti i Ministrit ne pergjigjen e tyre nuk argumentoi në mënyrë ligjore shkaqet e verteta te ketij mosveprimi, por sqaroi se neni i mesiperem ishte bërë i pazbatueshëm për arsye se Spitali i Burgjeve dhe Byroja e Ekspertimit ishin tashme ne varesi te Ministrise se

Drejtesise dhe kjo vartësi e zhvishte Ministrinë e Shëndetësisë nga detyrimi i mesiperm.

Me kete pergjigje Avokati i Popullit nuk ka qene dakort, pasi të sëmuret që qëndronin brenda sistemit të burgjeve duhet te ishin nën juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë, e cila duhet te vendoste per komponente te tille qe lidhen me trajtimin e tyre si:

“Planimetria e vendosjes së ambientit të spitalit; numri i pavioneve; numri i pacientëve; hapësira për çdo pacient; kushtet e sigurisë së larte; paisjet e mjedisit ku qëndron pacienti dhe të pavionit; numri i punonjësve për çdo shërbim; repartet për rehabilitim psiko –social dhe stafi këtyre reparteve etj”.

Keto elemente duhet te ishin medoemos pjese e nje rregulloreje te perbashket te dy ministrive te mesiperme. Vetem kohet e fundit kemi marre vesh ne rruge jo zyrtare se po punohet per miratimin e nje akti te tille.

Me këmbënguljen e Zyrës së Avokatit të Popullit, ish Kryministri Fatos Nano nxorri urdhërin Nr. 55 datë 11.04.2003 “Për ngritjen e grupit të punës për zgjidhjen e problemit të sistemit dhe trajtimit të personave me çrregullime mendore, të dënuar për kryerjen e një veprë penale”. Me anën e këtij urdhëri kërkohet ngritja e grupit të punës për studimin dhe përcaktimin e mënyrës së zgjidhjes përfundimtare të problemit të sistemit dhe trajtimit të personave me çrregullime mendore, të dënuar për kryerjen e veprave penale si dhe përgatitjen e akteve të nevojshme, ligjore e nënligjore. Në përbërje të këtij grupi ishte i ftuar edhe një përfaqësues nga zyra e Avokatit të Popullit.

Ne debatet dhe shqyrtimin e çështjeve te ngutshme ne kete komision nga ana e zyres tone u dhanë mendime dhe kontribute maksimale, duke hartuar majde edhe draftin e rregullores se përbashkët të dy Ministrive për ruajtjen e personave me masë mjekësore, caktimin e vendit ku do të strehoheshin këta persona, mënyrat konkrete të zgjidhjes së problemit etj. Por edhe në këtë rast koha tregoi se nuk ju dha zgjidhje problemit. Ashtu siç u shprehëm edhe me lart kjo çështje nuk ka përfunduar ende. Edhe tashme kur kane nisur negociatat e reja per te miratuar nje urdher te perbashket, kontatohet se nuk po merret mendimi i specialisteve te vecante dhe i institucioneve te pavaruara qe kane nje eksperience te gjate ne kete fushe.

Si rezultat i nderhyrjeve tona me rekomandimet perkatse, por edhe nga raportet e ndryshme te paraqitura nga Komiteti i Parandalimit te Tortures se Keshillit te Europes dhe raportet e OJF-ve te ndryshme u pranua nje zgjidhje afat gjate sipas Ministrise se Shëndetësisë, duke u kaluar Spitali i Krujës (ne vitin 2004) në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Por kjo nuk zgjidhi problemin e të sëmurëve mendor të shpallur si të tillë

me vendim gjykatë, por vetëm problemin e të burgosurve të cilët pësojnë trauma psikike gjatë qëndrimit në burg.

Gjatë vitit 2005 Avokati i Popullit kreu një inspektim në Spitalin e Burgut Krujë dhe konstatoi një sërë parregullsish të cilat ndikonin drejtperdrejt në jetën dhe shëndetin e të denuarve me probleme mendore. Konkretisht ambjenti ishte me kushte jo të pershtatshme dhe kishte mungesa në ilaçe dhe në trajtimin ushqimor. Problemi i madh ishte mungesa e një mjeku psikiater pranë këtij spitali.

Edhe gjatë vizites së fundit që përfaqësues të Avokatit të Popullit kryen në këto spital në Mars 2008 u konstatua mungesa e mjekut psikiater.

Në një veshtrim të përgjithshëm nga menyrat se si trajtohen të denuarit me probleme mendore në këto spital në kuptim të cilësive të ushqimit, të ilaçeve, të kushteve higjieno-sanitare, të lageshtisë, por edhe të gjendjes së rrugës për të mbërritur apo u larguar si i semurë, e cila është jashtë çdo standarti automobilistik, të bëjnë të gjykosh se ekziston një trajtim i degradues që ju ofrohet këtyre personave në Spitalin e Burgut Krujë.

Perveç kësaj, për një arsye aspak të pranueshme, për shkak të mungesës në organikën e spitalit të një berberi, të semurëve mendore ju duhet të kryenin nevojat e tualetit të fytyrës së tyre vetë, duke qenë të rrezikuar vazhdimisht nga mjetet e mprehta që përdoren për një shërbim të tillë.

Në disa raste mjetet e lejuara, në kundërshtim me llogjikën me të thjeshtë, ishin bërë shkak për tentativa vetëvrasje të të denuarve dhe megjithatë ishte konstatuar ky fakt, nuk ishte marrë asnjë masë për heqjen e tyre. Mbi të gjitha, të semurët në këto spital nuk trajtohen si pacientë, por si të burgosur. Vetëm menyrat e mbajtjes së tyre me dhoma të mbyllura, të izoluar dhe me një rregjim aspak të lehtësuar për gjendjen e tyre shëndetësore është një aspekt mjaft i rëndësishëm i degradimit të tyre të pakthyeshëm shëndetësor.

Në vazhden e përpjekjeve për një shërbim shëndetësor të pranueshëm për të denuarit, Avokati i Popullit është angazhuar gjithmone në ato raste kur mungesa e akteve nënligjore zbatuese është bërë shkak për shkeljen e të drejtave të të semurëve mendor.

Në këto raste, nëpërmjet rekomandimeve kemi kërkuar hartimin e tyre, për të bërë të mundur zbatimin në praktike në menyrë sa më korrekte të kuadrin ligjor në fuqi. Kështu ka ndodhur në rastin e rekomandimit të datës 13.06.2003 ku kërkohej marrja e masave për zbatimin e Ligjit nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor“ dhe konkretisht plotësimi me Rregulloren që kërkon nënartikullin 23 të këtij ligji. Sipas këtij nënartikulli Ministri i Shëndetësisë detyrohet të nxjerrë një rregullore, ku të përcaktojë përbërjen e një komisioni të përhershëm që të përligjë masat e kufizimit fizik.

Nga verifikimet tona rezulton se ende një rregullore e tillë e veçante nuk është miratuar. Por nga aktet e permendura ne pjesën e parë të këtij dokumenti, del se Ministria e Shëndetësisë ka miratuar një Rregullore të shërbimeve të shëndetit mendor, duke prekur shumë pak dhe çështjen e kufizimit fizik. Por Rregullorja me vehte, ashtu siç përcakton edhe dispozita e mesiperme, nuk është bërë deri më sot.

Ne përfundim të trajtimit të disa aspekteve më negative që shoqërojnë trajtimin e të semurve mendore brenda sistemit të burgjeve mund të shprehemi se të gjithë personat për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar, vazhdojnë të qëndrojnë për rreth 10 vite, në kundërshtim me ligjin brenda sistemit të burgjeve.

Kjo ka bërë që jo vetëm shëndeti i tyre të mos vijë duke u përmirësuar, por ai po shkon drejt rendimit nga dita në ditë.

Ne një rekomandim të dërguar në Ministrinë e Drejtësisë gjatë vitit 2007 Avokati i Popullit kerkoi nga ana e këtij institucioni një ndërhyrje të menjehershme edhe për situatën e trajtimit të të semurve në Spitalin e Burgut Tiranë.

Edhe në këtë objekt, gjatë inspektimeve të zyres tona, rezultuan të njëjtat kushte që shoqërojnë rëndom ambiente të tilla si. psh, kushte jo të mira higjieno-sanitare, mungesë në ilaçe, mbipopullim, cilësi e ulët ushqimi, mungesë e një trajtimi edukues dhe argetues (ri-integrues etj).

Krahas kësaj, në një tjetër rekomandim gjatë vitit 2007, Avokati i Popullit i kerkoi Ministrinë të Drejtësisë që ndër të tjera të merrte masa për të gjithë ata gjyqtarë, të cilët nuk kishin rishikuar vendimet e tyre brenda 1 viti nga dhënia e tyre për shtrim të detyrueshëm në spital, siç përcakton Neni 45 i Kodit Penal. Nga 56 persona të shtruar me mjekim të detyruar, vetëm në një rast Gjykata e Mirditës kishte rishikuar vendimin e saj të mëparshëm. Kjo pasi në çdo kohë gjykata ka të drejtë që në rast se konstaton se nuk ekzitojnë shkaqet mjekësore të shtrimit të detyrueshëm mund të revokojë vendimin e saj. Një mos veprim i tillë e cenon rëndë ligjin dhe mban në mënyrë të padrejtë në një situatë tepër kritike dhe me heqje lirie individin brenda spitaleve të burgut. Ende sot institucioni ynë nuk disponon një përgjigje zyrtare për t'ju njohur me reagimet e Ministrisë së Drejtësisë për këtë shkelje kaq flagranteve të gjyqtarëve.

Kohët e fundit jemi informuar se po ndërtohet pranë Spitalit të Durrësit, ambienti ku do të strehohet kjo kategori personash, por rezulton përsëri se objekti është lënë në pronësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ne kemi mendimin se njëra nga godinat e këtij objekti duhet të kalojë në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ajo të caktojë personelin e saj për këtë institut psikiatrik. Kurse ruajtja të bëhet nga Ministria e Drejtësisë, në bazë të Rregullores së përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të

Shëndetësisë, që kërkohet të dalë sipas nenit 42 të Ligjit nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”.

Kjo duhet për të i paraprire ndonjë gabimi të rradhes, i cili mundet ta trajtojë edhe këte qender të re si burg të mirefillte dhe jo si qender spitalore të ruajtur në distance nga efektivat e Policisë së Burgjeve

Në mendojmë se duke zgjidhur problemet e ngritura më sipër, sigurohet zbatimi i ligjit dhe i trajtimit mjekësor të specializuar të personave të sipërmendur, duke bërë që më në fund të vihen në vënd të drejtat e tyre të nëpërkëmbura në vite.

4. Problematikat e shëndetit mendor në Spitalet Psikiatrike

Avokati i Popullit ka treguar një vemendje të veçantë edhe për të drejtat dhe trajtimin e pacienteve me probleme të shëndetit mendor në kushtet spitalore.

Që në vitin 2003, pas një inspektimi në Spitalin Psikiatrik të Qytetit të Tiranës, i është dërguar një rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë ku i është kërkuar zbatimi i menjehershëm i dispozitave të Ligjit Nr.8092 dt.03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”.

Konkretisht gjatë inspektimit u vënë re mangësi të mëdha në trajtimin e të sëmurëve, mbipopullim, mungesë në ilaçe, kushte të vështira higjieno-sanitare etj. Gjithashtu u kërkuar që të zbatoheshin dispozitat ligjore që parashikonin veprime të veçanta të mjekëve në rastet e shtrimit të detyruar, demobilizimin e të sëmurëve etj.

Megjithatë nderhyrjet e mëvonshme, vetëm kohët e fundit është bërë e mundur që në Spitalin Psikiatrik të Tiranës të investohet përfundimisht me parametra të pranueshëm për rregullimin e situatës.

Gjithsesi një problem në këte qender vijon të mbetet zënia e ambienteve të lira brenda zonës së spitalit nga individë të ndryshëm, të cilët e kanë bërë të vështirë shfrytëzimin e plotë të disa territoreve të jashtme nga të sëmurët.

Veprimtaria jone nuk ka ngelur vetëm në planin konstatues të gjendjes në Spitalin Psikiatrik të Tiranës. Gjatë viteve 2006-2007 pas marrjes së kompetencave me të plotë me ndryshimet në Ligjin “Për Avokatin e Popullit” u bënë inspektime në të gjitha spitalet e tjera psikiatrike në vënd.

Konkretisht gjatë vitit 2006, duke marrë shkas nga njoftimet e mediave, Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmoi me inisiativë një inspektim në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit. Pas ushtrimit të kontrollit për kushtet spitalore, administrimin mjekësor dhe për gjendjen e mjeteve ndihmëse në dispozicion të pacientëve, rezultoi se shtrimi i detyruar i

pacientit me simptoma akute, pa pëlqimin e tij ose te kujdestarit, nuk shoqerohej me paraqitjen e kërkesës së miratimit të masës së shtrimit të detyruar brenda 48 orësh në gjykatë.

Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientët e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit ishin të pamjaftueshme. Në momentin e kontrollit Spitali Psikiatrik në Elbasan kishte mbipopullim si dhe u konstatuan mungesa pajisjesh akomodimi. Shërbimi i ushqimit paraqitej në kushte të papërshtatshme. Nga kontrolli rezultoi mungesë artikujsh të higjenes personale, mungesë të xhamave në dritaret e dhomave dhe e ujit të ngrohtë. Furnizimi me veshje ndaj pacientëve ishte i pamjaftueshëm. Spitali Psikiatrik Elbasan në organikën e tij nuk kishte të punësuar psikologë, punonjës social dhe neurologë. Kjo kërkesë parashikohet si nga ligji, ashtu dhe nga vetë nevojat e kurimit të pacientëve.

Për 320 pacientë që kuroheshin në këtë spital kishte mungesë stafi mjekësor si dhe kishte mungesa periodike të medikamenteve bazë të trajtimit të rasteve akute, të cilat në mjaft raste kishin detyruar spitalin të kryente blerje të paautorizuara. Ndërkohë u konstatua një shpërndarje jo e drejtë e ilaçeve nga strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë, duke furnizuar nganjëherë spitalin e mësipërm edhe me ilaçe diabeti, për të cilat nuk kishte fare nevojë. U evidentua se kontrollet dhe inspektimet ndaj këtij institucioni kishin qenë pothuajse inekzistente nga ana e Ministrise se Shendetesise.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit ju drejtua ish Ministrit të Shëndetësisë Z. Maksim Cikuli me rekomandim për përmirësimin e trajtimit ligjor, shëndetësor dhe social të pacientëve të Spitalit Psikiatrik në Elbasan. Gjithashtu për problemet e evidentuara u vunë në dijeni edhe Kryeministri Zoti Sali Berisha, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë dhe Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në përgjigjen e tij, Ministri i Shëndetësisë duke vlerësuar pozitivisht nismën e ndërmarrë nga institucioni ynë në drejtim të standardeve të shërbimit të kujdesit shëndetësor mori disa angazhime.

Nga ana tjetër duke patur parasysh edhe kohën relativisht të gjatë nga hartimi i ligjit “Për Shëndetin mendor”, në kuadrin e rishikimit në tërësi të legjislacionit në këtë fushë, Ministria e Shëndetësisë e konsideroi partner Avokatin të Popullit, në këtë proces të rëndësishëm për rishikimin rrenjesor të këtij ligji.

Kurse në përgjigjen e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Elbasan u shpreh gjithashtu gatishmëria për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit në drejtim të ngritjes së kualiteteve të shërbimit ndaj të sëmurëve, nëpërmjet hallkave ligjore, përkujdesjes psikike, fizike, sociale dhe

reabilituese të tyre, të ushqimit e përmirësimit të kushteve fizike të ambjenteve spitalore, si dhe jemi informuar për disa hapa të bërë për të arritur objektivat e duhura.

Avokati i Popullit ne vijim te ndjekjes se ketyre problemeve deri ne zgjidhjen e tyre te plote, kreu serish gjate vitit 2007 një tjetër inspektim në Spitalet Psikiatrike të Elbasanit, te Vlores dhe te Shkodres.

Ne Spitalin Psikiatrik te Elbasanit rezultoi se ne ate spital gjendja nuk kishte ndryshuar shume pas inspektimit tone te bere ne vitin 2006:

1) Numri i pacienteve gjithsej 302, nga të cilët 113 pacientë akut dhe 189 pacientë kronik. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit eshte 310 pacientë. Situata paraqitet serish e mbipopulluar, pasi spitali po i nënshtrohej një rikonstruksioni dhe shumë dhoma ishin jashtë funksioni.

2) Numri i personelit mjekesor ishte në kuotën e 190 personave, nga të cilët 6 mjekë. Nga keta 1 mjek kishte specialitetin psikiatër, tre të tjerë kishin kryer një kurs 1 vjeçar specialiteti, ndërsa dy të tjerë ishin me eksperiencë të ekuivalentuar si specialiste të kësaj fushe.

Në spital ofronin shërbimin e tyre 49 infermiere, 35 kujdestare dhe pjesa tjetër prej 100 personash ishin staf ndihmës administrativ, mirëmbajtje dhe pastrimi.

3) Në zbatim te nenit 28 të Ligjit. Nr.8092 dt.21.03.1996 “*Për Shëndetin Mendor*” rezultoi se numri për shtrimet e detyruara që ishin kërkuar në gjykatë gjatë vitit 2007 ishte 18 raste. Por drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar revokimin e ndonje mase të shtrimit të detyrueshëm ndaj pacientëve që ndiheshin të përmirësuar.

4. Nga kontrolli u konstatua se numri i personave të abandonuar që nuk kishin kujdestarë nuk ishte i evidentuar nga personeli mjekesor dhe nuk figuronte si e dhënë e veçantë në kartelën e të sëmurit. Për rrjedhojë në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen e attributeve të kujdestarit.

5. Kuota ushqimore dietike ditore për pacientet e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit ishte e miratuar me një Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.28 dt.09.02.1998 në shumën 257 lekë/ditë. Kjo normë sipas drejtuesve të spitalit ishte e vjetër dhe nuk i përmbahej nivelit të ri të çmimeve të tregut ushqimor.

6. Kushtet higjeno-sanitare të ambjenteve paraqiteshin të pranueshme, sepse ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre.

Gjithashtu paraqitet problem mungesa e artikujve të veçantë të higjenës personale, sidomos të pacienteve femra.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies ishin përmirësuar ndjeshëm. Dhomat paraqiteshin në kushte normale, por mbetet problem mungesa e

dollapeve dhe komodinave. Ne asnjë rast spitali nuk ishte furnizuar me normativën e 6 kompleteve vjetore për veshjet e të sëmurëve.

8. Mjekimi i të sëmureve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e shpejtë të procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në çdo rast mjekët ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientët, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtateshin skemes së tyre të mjekimit. Furnizimi i Janarit të vitit 2007 për ilaçe ishte kryer në Korrik 2007. Mjeket shpesh herë detyroheshin të blejnë me të ardhurat e tyre ilaçe për të sëmuret, për shkak të rrezikut që paraqet për shëndetin e këtyre të fundit mungesa e medikamenteve në raste të veçanta.

Shërbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të tjera të mjaftueshme.

9. Nga kontrolli rezultoi se në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit ishte e punësuar me kohë të plotë një punonjese sociale dhe një psikologe. Numri i tyre ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Megjithatë drejtuesit e spitalit kishin kërkuar shtesë organike, ky propozim nuk ishte marrë ende në konsideratë.

10. Lidhur me detyrimin ligjor për perfshirjen e të sëmurëve me ç'rregullime mendore në veprimtari punuese brenda institucionit psikiatrik nga verifikimi ynë u konstatua se Spitali Psikiatrik i Elbasanit ofronte në dukje dy mundësi për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Së pari, brenda ambjentëve të tij ekzistonte një ambjent për poçeri balte dhe së dyti, në afërsi të tij ishte ndertuar një serë për mbjellje dhe rritje të bimëve të ndryshme.

11. Numri i personave të deinstitutionalizuar që nuk kishin nevojë për mjekim gjatë vitit 2007 ishte mjaft i vogël. 10 pacientë ishin të vendosur në një qendër komunitare në Qytetin e Elbasanit, ndërsa planifikohej edhe hapja e një qendre tjetër në Cërrik.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit kishin ndodhur brenda vitit 2007, pesë raste të vdekjeve të papritura, të cilat ishin marrë në analize të veçante edhe nga ekspertë të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë. Këto vdekje sipas versionit zyrtar mjeko-ligjor kishin si shkak ndalimin e funksionit jetësor të zemrës. Por për shkak të kundërshtimit të familjarëve nuk ishte kryer autopsi në asnjë rast, në një kohë që kjo është detyrim ligjor.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit nuk ishin rregjistruar raste të denoncimit të dhunës, përveçse midis pacientëve njëri me tjetrin.

Gjate inspektimit personeli drejtues ngriti një sërë problemesh të cilat ishin:

a. Mos trajtimi i diferencuar i stafit mjeksor me paga, me shpërblime dhe aplikim të moshës së pensionit më të ulët, për shkak të vështirësisë së punës që ata kryejnë.

b. Mos gjetja e mënyrave të reja për të motivuar mjekte të ardhshëm për të kryer detyrën e psikiatrit. Kjo mungesë mund të çojë në një degradim të plotë të këtij shërbimi në vitet e ardhshme, sepse mjekët e rinj nuk motivohen për këtë specialitetet.

c. Shqetesimi se Spitali Psikiatrik po kthehej në një azil, ku shumica e të shtruarve nuk merrnin mjekim, por strehoheshin vetëm se kishin prapambetje mendore dhe familja nuk i pranonte t'i rimerrte. Numri i tyre varionte në 170 vetë. Strategjia për të deinstitutionalizuar këta individë nuk po zbatohet.

Nga te dhenat e fundit jemi informuar se gjate vitit 2008 ka perfunduar ne kete spital rikonstruksioni i plote i godinës. Por per problemet e tjera te ngritura nuk jemi informuar për asnje ndryshim pozitiv.

Në Spitalin Psikiatrik te Vlores rezultoi se:

1. Numri i pacientëve gjithsej 215, nga të cilët 70 ishin pacientë akut dhe 145 pacientë kronik. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit ishte 240 pacientë.

2. Numri i personelit mjeksor ishte në kuotën e 153 personave, nga të cilët 8 mjekë, 42 infermierë, 27 kujdestarë dhe pjesa tjetër ishin staf ndihmes administrativ, për mirëmbajtje dhe pastrim.

3. Numri i rasteve të kërkuara nga Spitali Psikiatrik i Vlorës për miratim mase të shtrimit të detyruar në gjykatë ishte gjashtë. Në këtë numër nuk ishin përfshirë persona të tjerë të cilët, megjithëse ekzistonin në kushte të tilla, nuk kishin vendime të gjykatës. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar revokimin e masës së shtrimit të detyrueshem ndaj pacienteve që vleresonin se ishin përmirësuar.

4. Numri i personave të abandonuar që nuk kishin kujdestare ishte i evidentuar nga personeli mjeksor për rreth 40 persona. Por kjo e dhënë nuk figuronte në kartelën e të sëmurit si një kërkesë e veçantë informacioni, e detyrueshme nga ligji. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen etributeve të kujdestarit, personave që nuk interesohen për të sëmurët.

5. Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientet e Spitalit Psikiatrik të Vlorës ishin sipas drejtuesve të spitalit në kuota minimale, por të pranueshme në shumën prej 270 leke në ditë për pacient.

6. Kushtet higjeno-sanitare të ambjenteve paraqiteshin të pranueshme dhe ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre. Nuk kishte sistem qëndror ngrohje-ftohje. Gjendja e tualeteve ishte e përmirësuar, por nuk kishte standarte të krenaqshme higjene dhe pastertie. Gjithsesi ngelej

problem çështja e normativave të dusheve dhe tualeteve për numër pacientësh.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies ishin të pranueshme. Në çdo pavion ishin krijuar ambjente të veçanta ngrenie. Guzhina ishte në kushte të mira. Dhomat paraqiteshin në kondicione jo normale të mbipopulluara (15m² sip/5krevate), por kishte lagështirë të dukshme. Mbetej problem mungesa e dollapeve, komodinave, ndriçimit dhe shtretërit ishin mjaft të dëmtuar. Mbulesat dhe shtrojet e krevateve nuk ishin të mjaftueshëm dhe shpesh here kishte mungesa.

8. Mjekimi i të sëmurëve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e shpejtë të procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndëtsisë. Në çdo rast mjeket ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientet, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtateshin skemës së tyre të mjekimit. Rast për t'u përmendur kishte qenë kërkesa e tyre për një medikament të quajtur "parkopan" në eliminimin e efekteve anësore të ilaçeve të tjera, i cili kishte qenë në listën e ilaçeve që rimbusheshin nga skema, por që nuk kishte gjëndje.

Sherbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të mjaftueshme kurimi.

9. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës ishin punësuar me kohë të plotë dy punonjëse sociale dhe dy psikologë. Numri i tyre ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të përgjithshëm të të sëmurëve.

10. Nga kontrolli rezultoi se Spitali Psikiatrik i Vlorës nuk ofronte asnjë mundësi për përmbushjen e detyrimit ligjor për ri-integrim. Brenda ambjenteve të tij nuk ekzistonte ndonjë mjedis tjetër për t'u marrë me punë artizanale, sport apo veprimtari të tjera rehabilitimi.

11. Spitali Psikiatrik Vlore nuk kishte deinstitutionalizuar asnjë paciente, por sipas mjekëve ishin në pritje dhe të gatshëm të largoheshin një numër prej 16 pacientësh.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës nuk kishin ndodhur brenda vitit 2007 raste të vdekjeve të papritura ose të ushtrimit të dhunës. Ndërkohë që ekzistonte një komision konsultativ i psikiatrisë që shqyrtonte rastet e mundshme të dhunës dhe merrte masa ndaj personelit.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës nuk disponoheshin mjete shtrënguese çmobilizimi për të sëmurët, si këmisha force, krevate fiksuese etj. Në shumë raste mungesa e tyre ishte bërë burim rreziku i shtuar për pacientët e tjerë dhe vetë personelin mjekësor.

14. Spitali Psikiatrik i Vlores nuk ishte vizituar nga të dërguar të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2007. Në asnjë rast nuk ishin kryer

inspektime të detajuara, dhe nuk ishin lënë detyra konkrete për kushtet dhe masat e tjera në dobi të pacientëve.

15. Si komente të tjera që morëm nga vete personeli drejtues dhe stafi ndihmes gjatë këtij inspektimi ishin:

a. Raporti i numrit të mjekëve, personelit ndihmës dhe pacienteve ishte shume i zhdrejtë.

b. Personeli mjeksor ndihej i rrezikuar nga sjellja e pacienteve në kriza akute, sepse nuk dispononin mjete mbrojtëse efikase.

c. Shqetesimin se Spitali Psikiatrik po kthehej në një azil ku shumica e të shtruarve nuk merrnin mjekim, por strehoheshin vetëm se kanë prapambetje mendore dhe familja nuk pranonte t'i rimerrte.

d. Niveli arsimor i kujdestarëve është shumë i ulët dhe ndikonte negativisht ne trajtimin e të sëmurëve.

Në Spitalin Psikiatrik te Shkodres rezultoi se:

1. Numri i pacientëve gjithsej 70, nga të cilët 20 ishin pacientë akut dhe 50 paciente kronikë. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit ishte 80 vende.

2. Numri i personelit mjeksor ishte në kuotën e rreth 30 personave, nga te cilet 3 mjekë, 10 infermiere, 10 kujdestar dhe pjesa tjetër ishin staf ndihmes administrativ, mirembajtje dhe pastrimi.

3. Nga inspektimi rezultoi se Spitali Psikiatrik Shkoder në asnjë rast nuk kishte kërkuar në gjykatë miratimin e masës së shtrimit të detyruar.

4. Nga kontrolli u konstatua se numri i personave të abandonuar që nuk kishin kujdestarë ishte i evidentuar nga personeli mjeksor në rreth 80% të pacienteve. Por kjo e dhënë nuk figuronte në kartelën e të semurit. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen e attributeve të kujdestarit.

5. Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientët e Spitalit Psikiatrik të Shkodres ishte sipas drejtuesve të spitalit në nivele minimale. Gjithsesi referuar çmimeve të tregut nga ana e tyre ndihej e nevojshme që ajo të ngrihej sa më shpejt pasi ishte e pamjaftueshme.

6. Kushtet higjeno-sanitare të ambjenteve paraqiteshin të papranueshme dhe nuk ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre. Nuk kishte sistem qëndror ngrohje-ftohje. Gjendja e tualeteve ishte e dobët. Ngelej problem çështja e dusheve pasi ato nuk mund të mbulonin asnjëherë nevojat e pacienteve.

Gjithashtu paraqitej problem mungesa e artikujve të veçantë të higjenës personale sidomos të pacienteve femra.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies nuk ishin normale. Në çdo dhomë ishin krijuar ambjente të veçanta ngrënie, krahas një mence që ekzistonte në çdo pavion. Por gjendja e tyre ishte mjaft e keqe. Dhomat paraqiteshin në kushte jo normale dhe mbetej problem mungesa e dollapeve,

komodinave, ndriçimit dhe shtretërit ishin mjaft të dëmtuar. Mbulesat dhe shtrojet e krevateve nuk ishin të mjaftueshem dhe shpesh herë kishte mungesa. Përgjithësisht godina e këtij shërbimi paraqitej tepër e amortizuar dhe e dëmtuar.

8. Mjekimi i të sëmurëve shoqerohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonesave në kryerjen e procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në çdo rast mjeket ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mire mbi pacientet, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtaten mjekimit.

Shërbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të mjaftueshme.

9. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës nuk kishte të punësuar me kohe të plotë apo të pjesshshme ndonjë punonjës social apo psikolog.

10. Nga verifikimi i bërë u konstatua se Spitali Psikiatrik i Shkodrës nuk ofronte asnjë mundësi për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Brenda ambjenteve të tij ekzistonte një mjedis për t`u marrë me punë artizanale dhe veprimtari të tjera rehabilitimi. Por ai nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk vihej në shfrytëzim.

11. Spitali Psikiatrik Shkodër nuk kishte deinstitutionalizuar asnjë pacient dhe nuk ishte krijuar në asnjë rast mundësia dhe kushtet për të realizuar diçka të tillë.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës kishte ndodhur vetëm një rast vdekje e papritur brenda vitit 2007 për të cilën me insistim të mjekëve ishte bërë autopsi, nga ku rezultoi se pacientja kishte vdekur nga shkaqe natyrale.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës nuk ishin rregjistruar raste të denoncimit të dhunës. Spitali nuk dispononte mjete shtrënguese çmobilizimi për të sëmuret si kemisha force, krevate fiksuese, por vetëm një dhomë izolimi në kushte aspak të pranueshme dhe tepër të rrezikshme. Në disa raste hyrja në dhomën e izolimit ishte shoqëruar me plagosje të personelit mjekësor për shkak të mungesës së masave të sigurisë brenda këtyre ambjenteve.

14. Spitali Psikiatrik i Shkodrës nuk ishte vizituar nga të dërguar të Ministrisë së Shëndetësisë. Në asnjë rast nuk ishin kryer inspektime të detajuara, dhe nuk ishin lënë detyra konkrete për kushtet dhe masat e tjera në dobi të pacienteve.

15. Si komente të tjera që morëm nga vetë personeli drejtues dhe stafi ndihmës gjatë këtij inspektimi ishin:

a. Spitali Psikiatrik ka nevojë që të ndihmohet për të nxjerrë jashtë ambienteve të tij rreth 80% të pacienteve që rrinë në kushte azili dhe që nuk marrin mjekim.

b. Personeli mjeksor duhet të ndihmohej me organikë shtesë pasi numri aktual i punonjësve për pacientë ishte tepër i ulët. (3 infermierë në turn me 40 të sëmurë).

c. Duhesh vënë dorë me investime, pasi kushtet ishin shumë të papranueshme për të mjekuar dhe rehabilituar të sëmurë mendore.

Nga perpunimi i këtij informacioni ne shkalle vendi, Avokati i Popullit permbloodhi dhe pergjithsoi nje sere problematikash te cilat me pas me ane te nje rekomandimi ju vune ne vemendje, Ministrise se Shendetesise, dhe per dijeni Kuvendit te Shqiperise, Keshillit te Ministrave etj.

Pas nje përmbledhje per te tre spitalet psikiatrike te mesiperme, ne vija te permbledhura keto probleme u pergjithsuan si vijon:

1. Nga të dhënat dhe gjendja e konstatuar në të tre objektet e inspektuara, rezultoi se kushtet dhe trajtimi i të sëmurëve jo vetëm që linin shumë për të dëshiruar dhe nuk premtinin përmirësimin e shëndetit të tyre, por në shume raste ai ndikonte në përkeqsimin e tij.

2. Ligji Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” vazhdonte të mbetej një akt i pazbatueshëm në shumë dispozita të tij nga personeli mjeksor. Krahas trajnimit dhe direktivave të vazhdueshëm që Ministria e Shëndetësisë duhet të jepte për zbatimin e tij, detyrë e rëndësishme mbetej ndryshimi, amendimi dhe nxjerrja e akteve të reja nënligjore për implementimin e tij praktik.

3. Një mungesë në kuadër të akteve nënligjore mbetej rregullorja e re për kushtet e trajtimit të të sëmurëve mendore, ku të parashikohen normativat e reja të siperfaqeve për metër katror të hospitalimit të tyre, dushe dhe tualete për frymë, raport mjek/infermier/kujdestar-pacient etj, cilësia dhe sasia kalorike e ushqimit, norma të reja për veshje dhe shtroje, përlllogaritje e re e kosos së të sëmurit, diferencimi i shpenzimeve për nevojat e pacienteve femra etj.

4. Kërkimi i miratimit të masave të shtrimit të detyruar në gjykatë dhe heqja e të drejtës së kujdestarise mbeten dy momente të paqarta dhe të pazbatuara siç duhet nga personeli mjeksor. Avokati i Popullit sugjeroi se këto masa duhet të jenë pjesë e një procesi të dhënash dhe procedurash të parashikuara në rregulloret përkatse, pasi nga praktika rezulton se personeli mjeksor është i paqartë në zbatimin e tyre. Në asnjë rast shtrimi i detyruar nuk duhet të kryhet vetëm për personat me rrezikshmëri, por për të gjithë ata pacientë që nuk pranojne vendimin për shtrim. Nuk duhet harruar kjo procedurë ligjore dhe duhet zbatuar me përpikmeri, sepse në të kundërt

personelit mjeksor i duhet të perballlet me akuzën për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë etj.

5. Kuotat ushqimore të të sëmurëve vijojnë të mbeten në nivele minimale dhe nuk ishin rishikuar në përputhje me çmimet e reja të tregut ushqimor. Për këtë qëllim kjo çështje duhej analizuar dhe zgjidhur sa më shpejt për të përmiresuar ushqimin dhe llojshmerinë e tij në dobi të pacienteve.

6. Përveç ndërhyrjeve me investime që po kryeshin në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit, në dy spitalet e tjera gjendja e përgjithshme e ambienteve dhe kushteve të brendshme ishte shumë e amortizuar. Lavanderia, guzhina, mencat, dhomat e shtrimit, krevatet etj ishin të vjetëruar dhe tejet të demtuar. Avokati i Popullit është koshient për koston financiare që ka përmiresimi i këtyre kushteve, por të pakten kjo situatë duhej evidentuar dhe planifikuar në planet e ardhshme të investimeve buxhetore ose me anë të donatoreve vendas dhe të huaj.

7. Mjekimi dhe ilaçet për të sëmuret kishin mangësi të dukshme si në cilësi, larmi ashtu dhe në furnizim. Mjekët në mjaft raste u ankuan se procedurat e tejzgjatura të tenderimit dhe blerjes së ilaçeve nga Ministria e Shëndetësisë kanë shkaktuar probleme serioze në shëndetin dhe trajtimin me mjekim të të sëmurëve. Krahas kësaj në mjaft raste të tjera porosite për ilaçe specifike nuk merren në konsideratë, megjithëse ato janë më të lira dhe kanë efekt më të mirë se sa ato që vijnë nga furnizimi. Në këto kushte lind nevoja që procedurat e blerjes së ilaçeve të gjejnë formë të shpejta nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, aq më shumë kur flitet për medikamente të caktuara specifike, mungesa e të cilave çon në degradim të pashmangshëm të shëndetit të të sëmurëve mendore. Kjo gjendje duhet përmirësuar edhe në shërbimin stomatologjik të këtyre spitaleve, duke i furnizuar ato me medikamente mjekimi dhe jo vetëm me mjete për heqjen e dhëmbëve.

8. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ende nuk kishte filluar të koordinonte siç duhej punën për vënien në zbatim të detyrimeve ligjore për caktimin në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të punonjësve social. Gjithashtu spitalet kishin mungesa të theksuara edhe në specialitetin e psikologut.

Gjithsesi Avokati i Popullit nuk është ende në dijeni të ndonje strategjie në fushën e shëndetit mendor për të përthithur staf të ri mjeksor dhe të kualifikuar në këtë fushë, nisur nga nevojat që ka shërbimi psikiatrik dhe interesi i ulët që tregohet nga mjekët e rinj për punësimin në këtë shërbim.

9. Megjithëse ka një platformë kombëtare për mënyrën e deinstitutionalizimit të të sëmurëve, Ministria e Shëndetësisë në

bashkepunim me Spitalet Psikiatrike nuk janë përpjekur seriozisht për të arritur një objektiv të tillë. Spitalet Psikiatrike në shumicën e tyre, shfrytezohen në masën 70% për shërbimin azil dhe hotelerik. Kjo pasi familjaret apo kujdestaret nuk pranojnë të rimarrin në shtëpi personat tashmë të abandonuar. Gjithashtu numri i vendosur në qendrat komunitare vijon të mbetet në shifra të ulta në raport me nevojat e të sëmurëve.

10. Ambjentet e ushtrimit të veprimtarive çlodhëse, argëtuese, sportive, rehabilituese nëpërmjet punës etj, janë inekzistente ose janë të pranishëm vetëm për efekte optike të përmbushjes së standarteve të kërkuara, por që faktikisht janë të pashfrytëzueshme.

Në këto ambiente nga inspektimi i kryer rezultoi se nuk kishte të përfshirë në trajtim asnjë pacient dhe nuk ishin marrë masat minimale për blerje mjetesh ndihmëse për vënie në funksionim të tyre. Në këto kushte Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me spitalet respektive duhet të krijojne një fond të veçantë për krijimin e kushteve të reja me efektivitet të plotë.

11. Rastet e vdekjeve të papritura dhe dhunës në këto spitale nuk janë parë në kuadrin e një standartizimi për trajtimin e tyre ligjor. Përveçse ekziston Urdhëri i Mjekut është e nevojshme që në çdo Spital Psikiatrik të jetë i ngritur një komision keshillimor që të marrë në analize dhe të japë verdiktet e tij për rastet e dhunës.

Në shtimin e këtyre rasteve Avokati i Popullit mendon se mund të ndikojë edhe niveli i ulet arsimor dhe profesional i kujdestarëve. Ndaj dhe Ministrisë së Shëndetësisë i del si detyrë rishikimi i termave ekzistues për pranimin në këtë detyrë.

Nga inspektimi rezultoi se personeli mjeksor ishte mjaft i rrezikuar nga pacientet pasi nuk ekzitonin mjete efikase mjeksore dhe teknike për çmobilizimin e tyre në rast krizash akute psikike.

Krahas kësaj për çdo vdekje të papritur nuk duhej hezituuar nga ana e mjekëve që të kryhet autopsia. Çdo ngjarje e tillë nuk mund të kalojë vetëm me një analizë me inspektorët e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë kuadër Avokati i Popullit rekomandoi se duhet të vihen në zbatim edhe dispozitat e Ligjit Nr. 7830, datë 15.6.1994 “ *Për Autopsitë*”, i cili në rastet e vdekjeve brenda ambienteve spitalore kërkon vendimin e shefit të klinikes për kryerjen e autopsisë edhe pse mund të hasen kundërshtime nga familjarët.

12. Avokati i Popullit vërente se megjithë interesimin e Ministrisë së Shëndetësisë për këtë shërbim konstatohen vizita të pakta dhe në asnjë rast inspektime të mirëfillta të saj. Kjo është justifikuar deri diku me informacionin që shkëmbehet midis ministrisë dhe spitaleve për qellime të

ndryshme. Por gjithsesi kjo praktike pune ngelet larg nevojës së një kontrolli sistematik dhe të plotë në kushte terreni.

13. Një çështje tjetër, e cila kërkon një trajtim më vete, mbetet trajtimi i diferencuar i personelit mjekësor të shërbimit të psikiatrisë. Duke parë kushtet e vështira, problematikën e pacientëve dhe intensitetin e lartë të punës që zhvillohet me ta, vlen që kjo kategori mjekësh dhe stafi mjekësor të trajtohet në mënyrë të veçantë si nga paga, orët e punës, shpërblimet, mosha e daljes në pension etj.

Avokati i Popullit gjykon se ndërmarrja e një iniciativë të tillë nga Ministritë kompetente do të rriste edhe interesin e mjekëve të rinj për të ofruar kontributin e tyre në këtë shërbim, pa të cilin ky i fundit do të pësojë një degradim të shpejtë në të ardhmen.

Me ane të ketyre pergjithsimeve, të cilat vijojnë të jenë një shqetësim për spitalet psikiatrike në vendin tonë, Avokati i Popullit kërkon të verë dhe një herë në vëmendje të Kuvendit të Shqipërisë faktin se një situatë e tillë është e papranueshme dhe duhet të ndryshojë sa më parë nëpërmjet një koordinimi efektiv të punës të disa ministrive dhe organeve të tjera shtetërore, duke mos përjashtuar dhe ndërmarrjen e nismave ligjore dhe nenligjore për përmirësimin e situatës.

5. Përfundime dhe Rekomandime

Në përfundim të prezantimit të një sere çështjesh që shqetësojnë sot shërbimin mendor në vendin tonë, Avokati i Popullit ndjen nevojën të parashtrijë në këtë pjesë të fundit të Raportit disa përfundime dhe rekomandime, të cilat shprehin që do t'i shërbejnë Kuvendit të Shqipërisë në reagimet e tij për përmirësimin e një sere aspektesh të kësaj fushe. Institucioni ynë ka arritur në këto përfundime:

- 1) Gjendja e trajtimit të të sëmurëve mendorë në vendin tonë vijon të mbetet problematike dhe ka tendencë të rrisë shkallën e çënimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të pacientëve.
- 2) Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore kompetente që ofrojnë asistencën e tyre në shëndetin mendor kanë neglizhuar ndër vite të marrin në konsideratë serioze çështjet që shqetësojnë këtë kategori personash, duke dhënë një imazh negativ të këtij shërbimi.
- 3) Organet shtetërore nuk kanë arritur të trajtojnë me interesim të veçantë çështjet ligjore dhe nenligjore që kanë nevojë për ndryshim apo miratim, me qëllimin për të përmirësuar aspekte mjaft të rëndësishme të shëndetit mendor.

- 4) Ende nuk eshte formesuar nje mentalitet i ri ne administraten shtetereore qe te vleresoje dhe te tregojte rendesine e duhur ndaj shtresave ne nevojte dhe veçanerisht ndaj te semureve psikike.
- 5) Sherbimi shendetesor nuk po punon të rrite standartet e kerkuara ndaj personave me semundje mendore per vete mungesen e ideve dhe strategjive per te ofruar mjekë te rinj ne kete shërbim, për t'ju krijuar atyre dhe stafeve mbeshtetese lehtesite e nevojshme.

Nisur nga kjo gjëndje Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon:

- 1) Ky raport të shqyrtohet në një mbledhje të posaçme, të përbashkët, me pjesëmarrjen e deputetëve nga Komisioni i përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë si dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Në këtë mbledhje të ftohen të marrin pjesë Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave. Mbledhja të kryesohet nga Kryetarja e Kuvendit ose një nga zëvendësat e saj.
- 2) Në një kohe te pershtatshme, nje grup deputetesh se bashku me Avokatin e Popullit, te vizitojne disa nga Spitalet Psikiatrike dhe Qendrat Komunitare per te pare nga afer respektimin e te drejtave te pacienteve të sëmurë mendorë.
- 3) Mbledhja t'u kërkojë Ministrive përkatëse qe te japin shpjegime per shkeljet e konstatuara ne kete Raport dhe per masat që do të marrin që te korrigjohen keto dukuri sa me shpejt.
- 4) Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Komisioneve të përhershme parlamentare të mbajë në një vëmendje afatgjatë problematikat e ngritura dhe në mënyrë periodike të kërkojë nga ministrinë e linjës informacione.
- 5) Ne bashkepunim te ngushte edhe me perfaqesues te OBSH-se dhe OJF-ve te tjera te organizohen diskutime per menytrat me te mira se si mund te dale ky sherbim nga kriza qe e ka perfshire.

6. Kopje e dokumentacionit per veprimtarine qe ka zhvilluar Avokati i Popullit per mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave te personave te semure mendore